



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

Nr. 3793 Prot.

Vau Dejës, me 21.05.2026

**Lënda:** Njoftim për mbledhjen e Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

**Drejtuar:** Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore" neni 53 pika 4, neni 56 pika 2, neni 57 pika 2 germa c, ju njoftojmë se mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës zhvillohet ditën e Ejte me datë 28.05.2026, ora 14:00. Mbledhja do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Vau Dejës, Njësia Administrative Bushat.

**Me këtë rend dite:**

- 1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 29.04.2026 dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.
- 2.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Prill 2026.
- 3.Projekt vendim për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës nr.3016 prot. datë 15.04.2026 dhe Këshillit qarkut Shkodër nr.274 prot. datë 15.04.2026 "Për bashkëpunim ndërvendor në fushen e shërbimeve publike për kryerjen e investimit Rikonstruksion i godines së Qendres 'Besa' Barbullush Bashkia Vau Dejës"
- 4.Projekt vendim për shtesën e Buxhetit të Bashkisë Vau Dejës, Vkb nr. 74 datë 23.12.2025 "Sipas Akt Marrëveshjes nr.3016 prot. datë 15.04.2026 ndërmjet Këshillit qarkut Shkodër dhe Bashkisë Vau Dejës"
- 5.Projekt vendim për miratimin e njohjes si posedues jopronarë për aplikimet e bëra në disa zona të miratuara me VKM Nr.780 datë 19.12.2025 "Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Vau Dejës".
- 6.Projekt vendim "Për vazhdimësinë dhe vlerën e perfitimit për z. Pjeter Zefi në programin e strehimit "Subvencioni i qirasë, në tregun e lirë".
- 7.Projekt vendim për miratimin e sistemit të pikëzizmit për programin e strehimit social.
- 8.Raport i performances për Bashkinë Vau Dejës, viti 2025.
- 9.Të ndryshme.

Komisionet e këshillit do mblidhet ditën e Marte, datë 26.05.2026 ora 09.00 pranë Nj.A Bushat.

- 1.Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.
- 2.Komisioni i Financave,Buxhetit,Pasurive Bashkiake dhe planifikimit të zhvillimit strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare.
- 3.Komisioni i bujqësisë, pyjeve, menaxhimit të ujërave, mbrojtjes së mjedisit dhe biodiversitetit.

Kryetari Këshillit  
Ervis Shimaj